22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. / prot.

Tiranë, më 14.07.2022

**Lënda:** Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

**ZNJ. A B**

**BIRN ALBANIA**

Rruga " ", Kulla , Ap.
Të dhënat e kontaktit: e-mail:

**E nderuar znj. B**

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentesh, të datës 13.7.2022, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. prot., datë 13.7.2022, ju sqarojmë se:

Kërkesa për vënie në dispozicion të rezultateve përfundimtare të hetimit administrativ për ish-prokurorin z. P F , nuk mund të përmbushet, pasi dosja me rezultatet e hetimit pëmban të dhëna dhe informacione që nuk mund të bëhen publike. Raporti me rezultatet përfundimtare të hetimit i është përcjellë organit kompetent, siç edhe KPK e ka njoftuar në faqen e saj zyrtare në maj të vitit 2019.

Në bazë të nenit 17, pika 2, gërma "b", të ligjit nr. 119/2014, ky informacion kufizohet, pasi cenon parandalimin, hetimin e ndjekjen e veprave penale. Sa kohë kjo çështje është në juridiksionin e një organi të posaçëm hetimi, KPK nuk mund të cenojë procesin e këtij organi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Edmond Vercani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT